



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 374/5 prot.

Tiranë, më 4.10.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 774, datë 14.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Vukaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 19.9.2024, është njoftuar vendimi nr. 774, datë 14.6.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 774, datë 14.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK, ish-DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1. ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Petrit Vukaj”,² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit Raportin nr. *** prot., datë **.11.2017, për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit *** Vukaj”. Pas kërkesës së Komisionit për përditësim, AKSIK ka përcjellë të deklasifikuar plotësisht Raportin e kontrollit të figurës³ për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Vukaj.

2.3. KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit, z. Petrit Vukaj.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1. Për vlerësimin e pasurisë: [...] Për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me blerjen e pasurive në momentin e krijimit të tyre, si dhe me kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2009, 2010 dhe 2016, e cila rezultoi në vlerën (-) 1.459.774 lekë, e shpërndarë ndër vite, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion ...vlerësohet nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit⁵[...].⁶

3.2. Për kontrollin e figurës: [...] trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat në kuptim të kreut V të ligjit nr. 84/2016, apo specifikisht të nenit 38 të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.2.2018.

³ Shkresa e AKSIK me nr. *** prot., datë **.11.2023. Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë **.11.2023, të KDZH-së.

⁴ Raport i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. *** prot., datë **.7.2023.

⁵ Referuar vendimit nr. 4 (JR), datë 16.2.2023, të Kolegjit.

⁶ Për më tepër referohuni në f. 41, të vendimit të Komisionit.

po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe nuk mund të arrijë në një konkluzion tjetër, përveçse ai ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është çmuar edhe në raport me të dhënat negative të konfirmuara nga organet ligjzbatuese, që lidhen me verifikimin e kontrollit të figurës apo me mungesën e të dhënave të tjera përgjatë hetimit lidhur me figurën e subjektit [...].⁷

3.3. Për vlerësimin e aftësive etiko-profesionale: [...] trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë” [...].⁸

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 55, pika 5, nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit): Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura, Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 774/2024, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

⁷ Për më tepër referohuni në f. 47-48 të vendimit të Komisionit.

⁸ Për më tepër referohuni në f. 68, të vendimit të Komisionit.

10. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 774, datë 14.6.2024, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Pasuria e paluajtshme “**Truall me sip. 300 m² dhe banesë 2 kate, kati përdhe 104 m², kati i parë 102 m², objekt ndihmës 23 m²”**, ndodhur në lagjen “**** **”, Fier⁹ (në vijim referuar “banesë 2 kate”).

11.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Truall dhe shtëpi banimi 2-katëshe: kati i parë 104 m², kati i dytë (papafingo) 102 m² + ambient ndihmës 1 kat 23 m². Truall i marrë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist në datën **.9.1991. Kati i parë ndërtuar në 1992. Kati i dytë në vitin 2008, 2009, 2010. Vlera: 17.645.526 lekë. Rivlerësuar me referencë ***, datë **.8.2011*”. Pjesa takuese:100%”. Subjekti nuk ka deklaruar shumën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj banese dhe as burimin e krijimit.

11.2 Në DV-2003, subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi private 2 dhoma dhe një kuzhinë, ndodhur në *** ***, Fier. Nr. pasurie **/**. Trualli marrë nga shteti 1991 si i pastrehë, ndërtuar me të ardhurat e mia*”. Vlera nuk deklarohet.

11.3 Në DV-2008, subjekti ka deklaruar: “*Investim në godinën ekzistuese*”. Vlera: 285.000 lekë. Burimi i krijimit nuk deklarohet.

11.4 Në DV-2009, subjekti ka deklaruar: “*Investim në banesë, e cila ka të bëjë me shtesë të ambienteve të banimit me sip.57.6 m². Kati i dytë (proces legalizimi). Vlera 300.000 lekë*”. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit nuk deklarohet¹⁰.

11.5 Në DV-2010, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: “*Truall + banesë 2kt + ambient ndihmës, përfituar nga procesi i legalizimit. Vërtetimi hipotekor nr.**, datë **.6.2010. Sipërfaqe trualli 300 m². Sipërfaqe banese 104 kati i parë, 102 kati i dytë, ambienti ndihmës 23 m². Vlera 429.493 lekë. Një pjesë e kësaj vlere është paguar me bono privatizimi (70%) dhe pjesa tjetër me lekë në dorë sipas konfirmave bankare. Investime në banesë, të cilat kanë të bëjnë me ambientet e brendshme të shtëpisë. Vlera 74.000 lekë*”.

11.6 Lidhur me pasurinë “banesë 2 kate” në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë administruar aktet si vijon¹¹:

11.6.1 Vendimi nr. **, datë **.9.1991, i Komitetit Ekzekutiv Pluralist të *** ***, Fier që ka vendosur t’i japë truall për ndërtim shtëpie qytetarit Petrit *** Vukaj.

11.6.2 Leje ndërtimi, dhënë me vendimin nr. */**, datë **.6.1994, të Këshillit të Rrethit Fier, për z. Petrit *** Vukaj, për objektin “Shtëpi banimi”, ku parashikohet se objekti financohet nga vetë qytetari.

⁹ Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, kjo sipërfaqe ndërtimore referohet herë si kati i dytë 102 m², herë si kati i parë 102 m².

¹⁰ Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar dhe “Depo (objekt ndihmës) e ndërtuar në vitin 1998, e cila është në proces legalizimi së bashku me truallin e banesës ekzistuese. Vlera 25.000 lekë”.

¹¹ Referohuni akteve të përcjella nga ASHK me shkresën nr. ***/* prot., datë **.2.2021 dhe ZVRPP me shkresën nr. ***/*prot., datë **.8.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

11.6.3 Vendimi nr. ***, datë **.9.1994, i Gjykatës së Rrethit Fier, ku është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuarit Petrit Vukaj për vërtetim fakti juridik, duke e njohur bashkëpronar me bashkëshorten e tij *** ***, mbi pasurinë shtëpi banimi njëkatëshe, të ndodhur në “**** **”, e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, aneks, korridor, banjë e verandë.

11.6.4 Formular vetëdeklarimi për legalizim objekti me nr. *** prot., datë **.10.2006, me vetëdeklarues, z. Petrit Vukaj, i cili ka deklaruar: “Shtëpi banimi 1 kat”, me adresë: lagja “**** **”, viti i ndërtimit 1992, sipërfaqe e zënë 300 m², sip. ndërtimi 102 m² dhe garazh 23,60 m².

11.6.5 Akt kolaudimi datë **.2.2009, për objektin banesë 2-katëshe, ndodhur në lagjen “**** **”, Fier, me investitor z. Petrit Vukaj. Sipërfaqja e ndërtimit të katit përdhe 102 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit të katit të parë 102 m². Në vijim citohet se nga kontrolli i ushtruar në objekt rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim.

11.6.6 Leje shfrytëzimi objekti, e lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës pranë Këshilli të Qarkut Fier, datë **.2.2009, ku ndër të tjera citohet se objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit.

11.6.7 Kontratë kalimi të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** rep. nr.*** kol., datë **.4.2010, me objekt kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore me nr. pasurie **/***, me sip.300 m² blerësit Petrit Vukaj.¹²

11.6.8 Leje legalizimi me nr. ***, datë **.5.2010, për objektin “Godinë banimi 1 kat + objekt ndihmës 1 kat”, në favor të z. Petrit Vukaj, me këto të dhëna: “Zona kadastrale ***, nr. pasurisë **/***; sip. e parcelës ndërtimore 300 m²; sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 104 m², numri i kateve mbi tokë 1 (një), objekt ndihmës me sip. 23 m²”.

11.6.9 Vërtetim nga dokumentet hipotekore, datë **.6.2010, ku pasqyrohet se në pronësi të subjektit figuron e regjistruar pasuria nr. **/**, z.k. ***, me sip. 300 m² në adresën “**** **”, me përshkrimin; “*Truall dhe banesë 2 kate. Kati i parë 104 m², kati i dytë 102 m²+ambient ndihmës 1 kat 23 m²*”.

11.6.10 Kartelë e pasurisë së paluajtshme,¹³ ku konstatohet regjistrimi në pronësi të subjektit i pasurisë nr.**/***, z. k.***, me sip. 300 m² truall dhe 104 m² ndërtesë, ku në seksionin “Përshkrim i veçantë” citohet: “*Shtëpi banimi me papafingo me ref. ***... sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë **.5.2010, banesa 104 m², ambienti ndihmës 23 m²*”. Me ref. *** bëhet rivlerësimi i pasurisë në vlerën 17.645.526 lekë.¹⁴ Kati përdhe 104 m². Kati parë 102 m². Ambient ndihmës 23 m²”.

11.6.11 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) Fier, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.3.2024¹⁵, ka informuar Komisionin se subjekti ka qenë i pajisur me leje ndërtimi, miratuar me vendimin me nr. **, datë **.6.1994, të KRRT-së së Këshillit të Qarkut Fier, si dhe objekti i ndërtuar është pajisur me akt kolaudimi në datën **.2.2009, emërtimi i objektit banesë 2 kate, në lagjen “**** **”, Fier, ku përcaktohet se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim. Gjithashtu informon se objekti është i pajisur me leje shfrytëzimi nga Këshilli i Qarkut Fier, Drejtoria e Urbanistikës, datë **.2.2009, bashkëlidhur akt kontrolli, ku përcaktohet se objekti ka përfunduar.

¹² Referuar akteve bashkëlidhur rezulton se vlera totale e parcelës është llogaritur në shumën 400.000 lekë, nga të cilat 70% e totalit është paguar me bono privatizimi, në shumën 280.000 lekë. Bashkëlidhur është administruar dhe formulari i pagesës me lekë të parcelës ndërtimore, datë **.4.2010, për pjesën e mbetur prej 120.000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e administruar, subjekti ka paguar shumën totale prej 149.493 lekë, pranë Bankës ***.

¹³ Përcjellë nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.8.2017.

¹⁴ Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës **.8.2011, rivlerësimi i pasurisë është bërë në datën **.8.2011.

¹⁵ Depozituar nga subjekti, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1.

11.7 Komisioni në aktin “*Rezultatet e hetimit...*”,¹⁶ ka konstatuar se në lejen e ndërtimit të vitit 1994, në aktin e kontrollit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe në lejen e shfrytëzimit nuk pasqyrohet emërtimi i objektit 2 kate, sikurse pasqyrohet në aktin e kolaudimit. Referuar ligjit nr. 7693/1993, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, që ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë leja e ndërtimit nr. */**, datë **.6.1994, leja e ndërtimit jepej për një periudhë 6-mujore, e për pasojë shtesa e katit të dytë, e deklaruar nga subjekti gjatë deklarimeve periodike vjetore 2008-2009, është ndërtuar jashtë afatit të vlefshmërisë së lejes së ndërtimit.

11.8 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se duket se regjistrimi i ndërtimit “papafingo” dhe i katit të parë (dytë) me sip.102 m² në kartelën e pasurisë së paluajtshme nr. **/**, z.k. **, Fier, nuk bazohet në lejen e ndërtimit nr. **, datë **.6.1994 dhe në lejen e legalizimit nr. **, datë **.5.2010. Në përfundim, ka konstatuar se duket se regjistrimi i katit të dytë të banesës, me sip. 102 m² në vitin 2010 dhe në vitin 2017 është bërë jo sipas parashikimeve të ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

11.9 Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka dhënë shpjegime, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni në tërësi.

11.10 Lidhur me periudhën e ndërtimit të pasurisë “banesë 2 kate” dhe vlerën e investuar rezulton sa vijon:

11.10.1 Komisioni, lidhur me ndërtimin e katit përdhe, me sip. 104 m², bazuar në deklaratimet e subjektit në D-Vetting, formularin e aplikimit për legalizimin, si dhe në vendimin e datës **.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, ka konstatuar se periudha e ndërtimit të katit përdhe duket se ka qenë 1992 – shtator 1994. Ndërsa sa i përket vlerës së investuar për këtë kat, Komisioni, në kushtet kur nuk disponohen të dhëna zyrtare nga EKB mbi kostot e ndërtimit për vitet 1992-1994 i është referuar të dhënave për koston e ndërtimit të vitit 1995, nga Enti Kombëtar i Banesave për qytetin e Fierit, e cila rezulton të ketë qenë 13.517 lekë/m², shumë e cila është indeksuar me normën e inflacionit për vitet 1992-1994. Pas kryerjes së përlllogaritjeve, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83% për vitin 1996 (viti më i afërt), rezulton se kostoja totale e ndërtimit për katin përdhe është 594.785 lekë.

11.10.2 Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve të kryera për ndërtimin e katit përdhe me sipërfaqe 104 m², nga ku ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -532.756 lekë për ndërtimin e katit përdhe¹⁷.

11.10.3 Lidhur me ndërtimin e katit të parë, me sip. 102 m², në D-Vetting, në procesverbalin e ILDKPKI-së datë **.6.2016 dhe në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se katin e parë prej 102 m² e ka ndërtuar në vitet 2008-2009-2010.

11.10.4 Bashkëlidhur shkresës së ASHK-së me nr. **/** prot., datë **.2.2021, ndër të tjera janë administruar: (i) planimetritë e datës 13.1.2010, ku konstatohet planimetria e katit përdhe dhe e katit të parë + çati dhe (ii) procesverbali i konstatimit i datës 13.1.2010, i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, për objektin me sipërfaqe të përgjithshme të ndërtimit 161.6 m²

¹⁶ Referohuni f. 7 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

¹⁷ Komisioni ka analizuar periudhën e investimit dhe koston lidhur me objektin depo me sip. 23 m² dhe ka kryer analizën financiare për periudhën shtator 1994-1998, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për ndërtimin e depos me sip. 23 m².

dhe numri i kateve mbi tokë 2, ku citohet se objekti është i ndarë në kate: “kati përdhe 104 m², i parë 57,6 m²”.

11.10.5 Komisioni, për të përcaktuar kohën e ndërtimit të katit të parë dhe për të llogaritur koston e investimit, referuar dokumentacionit të administruar dhe deklarimeve të subjektit, ka marrë në konsideratë se deri në datën 31.1.2010, subjekti ka ndërtuar sip. 57,6 m² (duke e shpërndarë koston në vitet 2008- 2009), dhe në vitin 2010 sip. 44,4 m².

11.10.6 Komisioni, lidhur me shumën e investuar, për ndërtimin e katit të parë, referuar kostos mesatare të ndërtimit në qytetin e Fierit, në vitet 2008, 2009, kur subjekti ka ndërtuar shtesën me sip. 57,6 m², ka përllogaritur vlerën për këtë sipërfaqe ndërtimore në shumën 1.596.096 lekë (57,6 x 27.710 lekë/m²), e cila përllogaritet në vlerën 798.048 lekë për secilin vit (2008 dhe 2009). Ndërsa për vitin 2010, ka përllogaritur koston e ndërtimit për sipërfaqen ndërtimore prej 44,4 m² në vlerën 1.257.452 lekë (44,4 x 28.321 lekë/m²). Në vijim, Komisioni ka kryer përllogaritjet për shumën e koston së ndërtimit për vitet 2008-2009-2010, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit¹⁸, nga ku rezultoi një kosto totale prej 2.609.570 lekë.

11.10.7 Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e banesës. Në kushtet që në vitin 2009 subjekti ka blerë një pasuri të luajtshme automjet, Komisioni ka kryer analizën financiare të vitit 2009, të ndarë në dy pjesë, nga ku ka konstatuar pamjaftueshmëri për blerjen e pasurisë *automjet*, ndërsa nuk ka konstatuar problematika lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të investimit, të kryer në pasurinë objekt analize për vitin 2009.

11.10.8 Sa i takon shpenzimeve për investimin e kryer për vitin 2010, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -713.857 lekë, për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010.

11.11 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni në aktin “*Rezultatet e hetimit...*”,¹⁹ për pasurinë “banesë 2 kate”, ka konstatuar se: Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) në shumën -532.756 lekë, për ndërtimin e katit të përdhe dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1992-1994; (ii) në shumën -713.857 lekë, për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010 (në total -1.246.613 lekë) dhe, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

11.12 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, lidhur me mungesën e burimeve financiare për ndërtimin e katit përdhe ka pretenduar një vlerë investimi prej 30.439 lekësh, përkundrajt shumës 594.758 lekë, të llogaritur nga Komisioni, si dhe ka kërkuar të rishikohen disa zëra të analizës financiare. Lidhur me mungesën e burimeve financiare për ndërtimin e katit të parë, për të cilin subjekti pretendon një shumë investimi prej 650.000 lekësh përkundrajt shumës 2.609.570 lekë, të përllogaritur nga Komisioni, subjekti, edhe në këtë rast, pretendon se të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave nuk mund të arrijnë një vlerësim të drejtë të koston së ndërtimit, pasi ndërtimi i këtij kati nuk ka pasur vlerën e përllogaritur nga Komisioni, i cili ka përdorur si bazë llogaritjeje çmimet e EKB-së.

¹⁸ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, i Kolegjit, paragrafi 16.6.

¹⁹ Referohuni f.15-16 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

11.13 Komisioni, në përfundim, për pasurinë “banesë 2 kate”, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] Për sa i përket pretendimit të subjektit për përllogaritjen e shumës së investuar në katin e parë, në masën 650.000 lekë, përkundrejt shumës 2.609.570 lekë, të përllogaritur nga Komisioni, ku si rezultat është konkluduar në balancë negative në shumën 713.857 lekë, trupi gjykues vëren se, edhe pse duket se qëndron pretendimi i subjektit se nuk kemi të bëjmë me një ndërtim nga themelet dhe, për pasojë, edhe kostoja e ndërtimit nuk mund të jetë objektivistike reale, përsëri kjo pamjaftueshmëri nuk mbetet plotësisht e provuar, por çmohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt [...] ²⁰.

11.14 Komisioni, në përfundim, në vlerësimin tërësor për kriterin e pasurisë, referuar analizës financiare të rishikuar, nga ku i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 1.459.774 lekë ²¹, ka arsyetuar: [...] mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me blerjen e pasurive në momentin e krijimit të tyre, si dhe me kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2009, 2010 dhe 2016, e cila rezultoi në vlerën (-) 1.459.774 lekë, e shpërndarë ndër vite, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion i trupit gjykues, nisur dhe nga rrethanat e pasqyruara në pikën 28.43.9, vlerësohet nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit [...] ²².

11.15 Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë “banesë 2 kate”, referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, vëren sa vijon:

11.15.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në D-Vetting shumën e shpenzuar për investimin e kryer lidhur me objektin shtëpi banimi 2-katëshe dhe as burimin e krijimit të saj. Gjithashtu, edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e investimit për ndërtimin e katit përdhe, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

11.15.2 Deklarimet e subjektit në deklaratat periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010, lidhur me shpenzimet/investimet e kryera për ndërtimin e katit të parë, me sipërfaqe 102 m,² në një vlerë totale rreth 650.000 lekë, janë disa herë më të ulëta se vlera e llogaritur nga Komisioni, bazuar në kostot e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, që llogaritet në vlerë totale rreth 2.600.000 lekë. Gjithashtu, kjo vlerë e deklaruar prej 650.000 lekë, nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore, është disa herë më e ulët krahasuar me vlerën e rivlerësuar të këtij objekti në vitin 2011, që rezulton të jetë rivlerësuar për shumën 17.645.526 lekë.

11.16 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pasurinë “banesë 2 kate”, si dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe në deklaratat periodike vjetore shumën e shpenzuara/investuara lidhur me ndërtimin e katit të parë të këtij objekti.

²⁰ Referohuni f.18-20 të vendimit të Komisionit.

²¹ Konkretisht: (i) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -51.771 lekë, për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006; (ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën - 559.230 lekë, për blerjen e automjetit me targë AA *** **, në periudhën prill – maj 2009; (iii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -713.857 lekë, për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, në vitin 2010; (iv) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -134.916 lekë, në vitin 2016, për kryerjen e shpenzimeve.

²² Referohuni f. 40-41 të vendimit të Komisionit.

11.17 Komisioneri Publik, për sa i takon kohës së ndërtimit dhe mbulimit me burime të ligjshme të investimit të kryer për ndërtimin e katit të parë të “banesë 2 kate”, konstaton rrethanat faktike dhe ligjore të mëposhtme, lidhur me momentin e përfundimit të katit të parë me sip.102 m² :

11.17.1 Sipas Akt-kolaudimit të datës **.2.2009, që është depozituar si nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur D-Vetting, ashtu edhe nga ZVRPP Fier, rezulton se sipërfaqja e ndërtimit të katit të parë në këtë datë ka qenë 102 m². Gjithashtu, në këtë akt kolaudimi citohet se, në kontrollin e ushtruar në objekt, rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim.

11.17.2 ASHK Fier, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.3.2024, depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigje të Pyetësorit nr.1, konfirmon, ndër të tjera, se: [...] *ky objekt është pajisur me akt kolaudimi në datën **.2.2009, emërtimi i objektit banesë 2 kate, në lagjen “*** **”, Fier, ku përcaktohet se në kontrollin e ushtruar në objekte rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim ... Gjithashtu, objekti është i pajisur me leje shfrytëzimi nga Këshilli i Qarkut Fier, Drejtoria e Urbanistikës, të datës **.2.2009, e cila gjithashtu konfirmon se objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit [...].*

11.17.3 Vetë subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *në bazë të kërkesës time, drejtuar Këshillit të Qarkut Fier, Drejtoria e Urbanistikës pranë këtij këshilli, i ka përcjellë zyrtarisht me shkresën me nr. *** prot. dt. **/02/2009, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, dokumentet e mëposhtme²³: ... Akt kolaudimi, dt. **/02/2009, nga kolaudatori ing. *** ***. Leja e Shfrytëzimit [...]*²⁴.

11.17.4 Referuar ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” (të ndryshuar), akti (procesverbali) i kolaudimit të objektit është një nga dokumentet e nevojshme pjesë e dokumentacionit,²⁵ në bazë të të cilit ZVRPP-ja bën regjistrimin e objektit të përfunduar dhe lëshon certifikatën e pronësisë së të interesuarit.

11.17.5 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni lidhur me kohën e ndërtimit të katit të parë me sip.102 m², për sa më lart referuar, vlerëson se ndërtimi i katit të parë, me sipërfaqe 102 m², është konstatuar i përfunduar, më së paku në shkurt të vitit 2009. Si rezultat, kostoja e ndërtimit të katit të parë të *shtëpisë së banimit dykatëshe* duhet përfshirë në analizën financiare të vitit 2008.

11.18 Nga përfshirja në analizën financiare të vitit 2008 të investimit, të kryer për ndërtimin e katit të parë të pasurisë “banesë 2 kate”, në vlerën 2.584.761 lekë²⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimin e kryer për ndërtimin e katit të parë të “banesë 2 kate”, në vitin 2008, për një diferencë negative në vlerën 1.844.893 lekë²⁷.

²³ - Vendimi me nr. **, dt. **/09/1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Lagjes “*** **”. - Leje ndërtimi, dt. **/06/1994. - Sheshet e ndërtimit dhe Plani i vendosjes së Trojeve në *** ** Fier, të Qytetarit (Petrit Vukaj), ku është përcaktuar edhe njolla e ndërtesës. - Projekti i ndërtesës ku përfshihet: (i) Planimetria e katit përdhe; (ii) Planimetria e katit të parë; (iii) Prerja 1-1; (iv) plani i strukturave; (v) pamja kryesore e objektit. - Akti i kontrollit nga Seksioni i Urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Fier. - Akt kolaudimi, dt. **/02/2009, nga kolaudatori ing. *** ***. - Leja e Shfrytëzimit.

²⁴ Referohuni f. 6 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë 30.5.2024.

²⁵ Referuar nenit 13, të ligjit nr. 8402/1998, ZVRPP bën regjistrimin e objektit pas depozitimit të vendimit për sheshin e ndërtimit; lejes së ndërtimit, aktit të kolaudimit dhe lejes së shfrytëzimit.

²⁶ Kostoja për vitin 2008 është përlllogaritur në vlerën 2.826.420 lekë (102 m² * 27.710 lekë/m²). Duke zbritur nga kjo shumë vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, sipas jurisprudencës së Kolegjit, kostoja e ndërtimit të katit të parë llogaritet në vlerën 2.584.761 lekë.

²⁷ Referuar analizës financiare të Komisionit të administruar në dosje, nëse zërin “*shtëpi private ...*” e llogarisim në vlerë 2.584.761 lekë, atëherë pamjaftueshmëria për vitin 2008 rezulton në vlerën 1.844.893 lekë.

11.19 Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë “banesë 2 kate”, ndodhur ne lagjen “*** **”, Fier, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

11.20 *Komisioneri Publik* çmon të theksojë se, edhe në konsideratë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore dhe në shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ, se kati i parë i pasurisë “banesë 2 kate” është ndërtuar në vitet 2008, 2009, 2010, vëren se këto deklarime bien ndesh me përmbajtjen e aktit të kolaudimit datë **.2.2009, të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës.

11.21 Nga ana tjetër, nëse merren në konsideratë pretendimet e subjektit, se ndërtimi është kryer në vitet 2008, 2009, 2010, përveç sa konstatuar nga Komisioni lidhur me pamjaftueshmërinë, në këtë variant, çmojmë se konkluzioni i Komisionit, se: [...] *veprimet e ndërmarrja prej tij/subjektit në këtë proces dhe të konfirmuara nga organet kompetente sipas akt-konstatimeve në terren çmohen të tilla se ato nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'i vlerësuar si një sjellje e subjektit në shkelje të parashikimeve ligjore apo rregullave të etikës* [...] ²⁸, është i pasaktë, pasi ndërtimi i katit të parë me sipërfaqe 102 m², referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekore, datë **.6.2010, tregon se ndërtimi i katit të parë është kryer në mungesë të lejeve të organeve kompetente. Vlen të theksojmë se ndërtimi i kryer pa leje u parashikua si vepër penale me ndryshimet ligjore të Kodit Penal²⁹ dhe, eventualisht, do të përbënte shkelje të etikës së magjistratit. Një sjellje e tillë e jashtme, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i sistemit të drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit dhe pjesë e standardeve që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, edhe në këtë eventualitet, ky konstatim do të duhej të merrej në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

12. Automjet tip “Daimler Chrysler”, me targë AA * ****

12.1 Në D-Vetting, subjekti ka deklaruar: “*Automjet tipi ‘Daimler Chrysler’, C220CDI, viti i prodhimit 2001, me targa AA *** **. Blerë në vitin 2009. Vlera 3.600 euro + 348.430 lekë, shumë e përfituar nga shitja e Benzit me targë FR *** **. Pjesa takuese:100%*”.

12.2 Në DV-2005, subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Mercedes-Benz’, me targë FR *** **. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol. Vlera: 250.000 lekë*”. Pjesa takuese:100%. Nuk deklarohet burimi i krijimit.

12.3 Në DV-2009, subjekti ka deklaruar: (i) *Shitje makine me targa FR *** **, ndryshuar në FR *** ** (për shkak të dëmtimit të saj). Akt i shitjes nr. **-**, dt. **.04.2009. Vlera:1.000.000 lekë.* (ii) *Blerje makine tip Benz. Akt shitblerje nr. ***, datë **.4.2009, pagesa në doganën shqiptare, datë **.5.2008. Vlera 3.600 euro ose (460.800 lekë), 349.430 lekë. Pjesa takuese:100%.*

12.4 Komisioni ka analizuar blerjen dhe shitjen e automjetit me targa FR *** **, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targa AA *** **, të deklaruar në Deklaratën “Vetting”.

²⁸Referohuni pikës 47.8.2, f. 64-65 të vendimit.

²⁹ Referohuni ligjit nr.10 023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7985, datë 27.1.1995”, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, botuar në Fletoren zyrtare nr.190, datë 31.12.2008.

12.5 Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja³⁰, lidhur me automjetin me targa FR *** **, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targa AA *** **, rezulton se: (i) me kontratën nr. ***/***, datë **.8.2005, subjekti ka blerë nga shtetasi *** ** automjetin me targa FR *** ** (ndryshuar më pas në FR *** **), tip Benz 200, vit prodhimi 1992, me çmim 250.000 lekë. (ii) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të origjinës së automjetit të mësipërm, konstatohet se sipas kontratës së shitjes së mjetit të datës **.11.2004, shtetasi *** ** e ka blerë këtë automjet në Gjermani në vlerën 250 euro. (iii) Me kontratën e shitblerjes nr. ***/***, datë **.4.2009, subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin e mësipërm kundrejt çmimit 1.000.000 lekë, shtetasit *** **. (iv) Me kontratë shitje nr.*** rep. dhe nr. ***/** prot., datë **.12.2015, shtetasi *** ** e ka shitur këtë automjet kundrejt çmimit 100.000 lekë.

12.6 Subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin e datës **.6.2016, të mbajtur në ILDKPKI, lidhur me konstatimin se automjeti i blerë në vlerën 250.000 lekë pas 4 viteve përdorimi është shitur me një vlerë 4 herë më të lartë, ka deklaruar, ndër të tjera, se arsyeja e shitjes së këtij mjeti me këtë vlerë ka qenë mirëmbajtja e tij.

12.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit...”,³¹ ka konstatuar se: (i) Subjekti ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me shpenzimet apo investimet e kryera për rritjen e vlerës së automjetit me targa FR *** **. Për pasojë, çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes nr. ***/***, datë **.4.2009, në shumën 1.000.000 lekë, nuk është marrë në konsideratë në analizën e burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit tjetër me targë AA *** **; (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë, për blerjen e automjetit me targë AA *** **, në vitin 2009, dhe bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12.8 Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, në përfundim, ka arsyetuar se: *[...] nga të dhënat e dala përgjatë hetimit, vlera e shitjes së këtij automjeti është jashtë logjikës financiare, sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet dhe, për pasojë, nuk mund të shitet më shtrënjtë ... në rrethanat faktike të kësaj çështjeje, në kushtet që subjekti në funksion të barrës së provës nuk arriti të provojë shpenzimet e kryera të pretenduara si investime të kryera për rritjen e vlerës së automjetit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se për efekt të analizës financiare të konsiderojë shumën 250.000 lekë, që përkon me çmimin e blerjes së automjetit në vitin 2005, duke konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë, për blerjen e automjetit me targë AA *** **, në vitin 2009 ...subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit për këtë subjekt [...]*³².

12.9 Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë automjet tip “Daimler Chrysler”, me targë AA *** **, me burim të deklaruar krijimi shitjen e automjetit me targë FR *** **, çmon të drejtë vlerësimin e Komisionit për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme për blerjen e

³⁰ Referohuni shkresës së DPSHTRR-së nr. ***/**, datë **.10.2023 dhe akteve bashkëlidhur.

³¹ Referohuni f.18-19 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

³² Referohuni f. 23-24 të vendimit të Komisionit.

automjetit me targë AA *** ** shumën 1.000.000 lekë, nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe konstatimin lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën -559.230 lekë.

12.10 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me shpenzimet apo investimet e kryera për rritjen e vlerës së automjetit. Shitja e këtij automjeti në një vlerë disa herë më të lartë, nuk është një logjikë normale financiare, për më tepër kur mjetet motorike, për nga natyra e tyre, janë mjete që amortizohen me kalimin e viteve.

12.11 Gjithashtu konstatohet se automjeti me targa FR *** ** është blerë në vitin 2004, nga shtetasi ***, ***, në shumën 250 euro, dhe është shitur në vitin 2015, nga shtetasi ***, ***, në shumën 100.000 lekë, shuma këto disa herë më të ulëta se vlera me të cilën e ka shitur subjekti në vitin 2009.

12.12 Sa më sipër çmohet se çmimi i shitjes së automjetit me targa FR *** **, në vlerën 1.000.000 lekë, nga subjekti i rivlerësimit, duket të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/i simuluar, që vjen në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe, si pasojë, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit³³, subjekti ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

12.13 *Komisioneri Publik*, lidhur me automjetin me targa AA *** **, me burim të deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit me targë FR *** **, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e automjetit me targë AA *** **, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

13. *Komisioneri Publik*, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se shkaqet e trajtuara më sipër në këtë ankim, si dhe pamjaftueshmëritë e konstatuara nga Komisioni, për vitet 2006 dhe 2016, çojnë në një rezultat financiar negativ, që tejkalon dhe nuk justifikon zbatimin e parimit të proporcionalitetit, duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

III.B Lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës

14. Kontrolli i figurës, si një ndër tri kriteret e rivlerësimit kalimtar, ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme³⁴ me persona të përfshirë në krimin e organizuar³⁵ apo të atyre që kanë kryer deklarim të pasaktë³⁶ të të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka marrë në analizë raportin e DSIK-së, si organi i njohur nga ligji, që ka mundësinë praktike për të bërë verifikime të thelluara edhe jashtë vendit, çka krijon mundësinë që të bëhet një hetim i plotë dhe i gjithanshëm.

15. Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën që plotësohet dhe dorëzohet nga vetë subjekti dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja³⁷. Bazuar në nenin 39/2 të ligjit nr. 84/2016, DSIK, me shkresën me nr.*** prot., datë **.11.2017, ka përcjellë

³³ Referohuni, ndër të tjera, qëndrimin të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 28/2019.

³⁴ Referuar pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr.84/2016, “kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

³⁵ Referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht... me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

³⁶ Sipas nenit DH, pika 4, paragrafi 2: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpjetet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehtë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

³⁷ Paragrafi i dytë i nenit DH të aneksit të Kushtetutës.

Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, me anë të cilit ka referuar: [...] *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës* [...]. Në përmbajtjen e raportit, pas verifikimeve të kryera nga autoritetet ligjzbatuese evidentohet se: [...] *Subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj është marrë në evidencë më datë **.10.2016, si person me precedent kriminal, nga strukturat për hetimin e krimeve, pasi me vendimin nr.***, datë **.11.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”...Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar në ngarkim të subjektit të rivlerësimit procedimin penal nr. ***/2015, për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Me vendimin e Gjykatës së Apelit, datë **.12.2016, është vendosur pushimi i çështjes për subjektin Petrit Vukaj, pasi nuk vërtetohet fajësia e tij për kryerjen e veprës penale* [...].

16. Komisioni ka kërkuar përditësimin e Raportit dhe AKSIK, me shkresën me nr. *** prot., datë **.11.2023, ka përcjellë Raportin³⁸ e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së me nr. ***, datë **.11.2023. Përfundimisht, AKSIK ka arritur në konkluzionin se: [...] *Grupi i punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Petrit *** Vukaj* [...].

17. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka kryer një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Vukaj, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të përfituara nga agjencitë ligjzbatuese / institucionet e verifikimit, nga i cili i ka rezultuar si vijon.

17.1 Subjekti, në përgjigjet e Pyetësorit standard ka deklaruar se në vitin 2014 ka përdorur automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë AA *** **, në pronësi të shtetasit *** ** për të vizituar në Athinë, Greqi, kunatin e tij *** **. Për këtë fakt ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë **.1.2021, të shtetasit *** ** **, si dhe kontratën e përdorimit të mjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2014, ku shtetasi *** ** i ka dhënë në përdorim subjektit automjetin “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2000, me targa AA *** **, për një periudhë 1-vjeçare, me qëllim përdorimi për nevoja vetjake, si dhe për përdorim jashtë shtetit.

17.2 Komisioni ka rënë në dijeni nëpërmjet mediave elektronike³⁹ se, në datën **.4.2021, shtetasi *** **, 55 vjeç, banues në Fier, është arrestuar nga shërbimet e policisë, me qëllim ekstradimi drejt Italisë, pasi ishte dënuar me 7 vite e 6 muaj burg nga autoritetet gjyqësore të Genova-s, në Itali, për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”.

17.3 Nga dokumentacioni i administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier⁴⁰ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier⁴¹, Komisioni ka konstatuar se gjeneralitetet e shtetasit të arrestuar përkonin

³⁸ Referuar këtij Raporti, subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

³⁹https://***.al/dergonte-femra-shqiptare-ne-itali-arrestohet-***-***; https://***.com/arrestohet-ne-fier-shqiptari-qe-ishte-shpallur-ne-kerkim-nderkombetar/

⁴⁰ Shkresë nr. ***/* prot., datë *.4.2024.

⁴¹ Shkresë nr. ***/* prot., datë *.4.2024.

me gjeneralitetet e shtetasit *** ***, të cilit subjekti i ka marrë në përdorim automjetin me targë AA *** **, në vitin 2014.

17.3.1 Nga aktet në dosje, rezulton se ky shtetas është dënua nga autoritetet gjyqësore në Genova, Itali, me 7 vjet e 6 muaj burgim, për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”, të parashikuara nga Kodi Penal italian, për faktin se nga data *.1.1994 deri më **.12.2020, në bashkëpunim me persona të tjerë ka rekrutuar dhe dërguar ilegalisht në Itali femra shqiptare, të cilat, më pas, nëpërmjet rrahjes dhe dhunës, i ka shfrytëzuar për prostitucion.

17.3.2 Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për vleftësimin e masës së arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj shtetasit *** *** (alias *** ***, lindur më **.11.1965, *** ***, lindur më **.12.1965, *** ***, lindur më **.12.1966), pasi në datën **.3.2021 Prokuroria e Përgjithshme e Italisë ka lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar, bazuar në urdhrin e ekzekutimit nr. ***/2002, datë **.8.2009, të Gjykatës së Genova-s, Itali, urdhër i cili është revokuar në vijim, është anuluar nga autoritetet italiane për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve, të transmetuar nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. ***/* prot., datë **.4.2021.

17.3.3 Në përfundim, Komisionit i ka rezultuar se shtetasi *** ***, në vitin 2001, është dënua në Itali për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”. Në kushtet kur vepra penale “Grup kriminal” sipas legjislacionit italian përkon me veprën penale “Grup i strukturuar kriminal”, që parashikohet në nenin 333/a, kreu XI, i Kodit Penal Shqiptar, bazuar në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi *** *** konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”. Referuar deklaratës për kontrollin e figurës, të dorëzuar sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien me shtetasin *** ***.

17.4 Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit..”,⁴² lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me pikën 4 të nenit DH, të aneksit të Kushtetutës, pasi duket se: (i) Kontakti i subjektit të rivlerësimit me shtetasin *** ***, nëpërmjet përdorimit të automjetit në vitin 2014 dhe, më tej, lëshimi i deklaratës noteriale në vitin 2021, është kontakt i papërshtatshëm faktik i subjektit me “person të përfshirë në krimin e organizuar”, sipas parashikimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pranimin e favorit të përdorimit të pasurisë/automjet nga shtetasi *** ***, në formularin e deklaratimit të figurës, sipas parashikimeve të shtojcës 3, pjesa 5, shkronja “e” e ligjit nr. 84/2016, pasi kësaj pyetjeje i është përgjigjur “jo”, në kushtet kur ky shtetas sipas parashikimeve të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”, pasi është dënua për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

17.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Ekzistencën e procedimit penal ndaj shtetasit *** ***, në shtetin italian, e kam mësuar për herë të parë nga ana juaj, nëpërmjet rezultateve të hetimit ...Për herë të parë e kam rastisur në vitin 2014, njohje e një mikut tim shtetasit *** ***. Këta dy shtetas posedonin, në dijeninë time, dy pikë karburantesh në qytetin e Fierit. Në atë periudhë, unë do të udhëtoja drejt shtetit grek, për të shkuar familjarisht tek kunati im, ... por automjeti im nuk ishte fort i përshtatshëm për udhëtime të gjata, i kërkova mikut tim, *** ***, automjetin e tij për vetëm 3 ditë udhëtimi...*

⁴² Referohuni f. 36 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

*i cili më siguroi një automjet tjetër, të mikut të tij. Unë nuk e njihja këtë person dhe as sot nuk kam asnjë njohje të drejtpërdrejt përveçse këtij momenti, në vitet 2014 dhe në 2021, kur për efekt të procesit të rivlerësimit i kërkova të lëshojë një deklaratë noteriale për të konfirmuar dhënien e automjetit për përdorim. Këta dy shtetas posedonin dy pika karburanti në qytetin e Fierit dhe mes tyre i lidhet e njëjta kategori biznesi. Një fakt të tillë e konfirmon edhe shtetasi *** ***, nëpërmjet Deklaratës noteriale, datë **.5.2024, ku deklaroi pikërisht faktin se unë me këtë shtetas nuk njihesha më parë dhe nuk kam patur asnjë marrëdhënie shoqërore... Referuar dokumentacionit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier rezultoi se ndaj këtij shtetasi ka nisur procedimi penal për ekstradimin e tij, për llogari të një vendimi gjyqësor italian, të vitit 2002, vetëm në vitin 2021, ndërkohë që plotësimi i Deklaratës Vetting nga ana ime është dorëzuar në janar të vitit 2017, pra 4 vite më përpara nga momenti i regjistrimit të procedimit, fakt të cilin unë nuk kisha si ta dija... Në vlerësimin final të Komisionit për kriterin e figurës duhet ta trajtojë kontaktin për përdorimin e automjetit për një afat shumë të shkurtër kohor të shtetasis *** ***, si një kontakt rastësor [...].⁴³*

17.6 Komisioni arriti në përfundimin se: [...] *Nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat në kuptim të kreut V të ligjit nr. 84/2016, apo specifikisht të nenit 38 të po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe nuk mund të arrijë në një konkluzion tjetër, përveçse ai ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është çmuar edhe në raport me të dhënat negative të konfirmuara nga organet ligjzbatuese, që lidhen me verifikimin e kontrollit të figurës apo me mungesën e të dhënave të tjera përgjatë hetimit lidhur me figurën e subjektit. Gjithashtu...nuk evidentohen elemente të tillë të arsyeshëm, të konsiderueshëm apo të perceptueshëm, për t’i kualifikuar si cenim të besimit të publikut, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...].⁴⁴*

17.7 Komisioneri Publik, për sa i përket deklarimit të subjektit, se: [...] *Është njohur lidhur me procedimin penal të shtetasis *** *** nga rezultatet e hetimit [...], duke marrë në konsideratë së bashku faktet se: i. arrestimi i shtetasis *** *** është publikuar nga të gjitha mediat në nivel kombëtar; ii. arrestimi i këtij shtetasi është bërë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier; iii. ndjekja e procedurave për ekstradimin e këtij shtetasi është bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, ku subjekti ushtronte funksionin; iv. pak kohë përpara se të arrestohej⁴⁵ shtetasi *** ***, subjekti i ka marrë deklaratën noteriale të datës **.1.2021, për përdorimin e automjetit të tij në vitin 2014; v. subjekti vetë ka deklaruar se shtetasi *** *** ushtron aktivitetin e shitjes së karburantit në qytet, aktivitet që ushtrohet nga pak subjekte tregtare, vlerëson se deklarimi i subjektit, se është njohur lidhur me procedimin penal të shtetasis *** *** nga rezultatet e hetimit të dërguara me email-in **.5.2024, nga Komisioni, nuk është i besueshëm, vlerësuar me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.*

17.8 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa arsyetuar Komisioni, se: [...] *Njohja e subjektit me shtetasin *** ***, nën rrethanat e paraqitura apo të pretenduara nga subjekti si njohje jo e drejtpërdrejtë, nuk mund t’i vishet subjektit si një veprim i hamendësuar apo të merret apriori për ta kualifikuar atë si një marrëdhënie shoqërore me një njohje të hershme të vazhdueshme, apo vetëm për marrjen e automjetit në përdorim [...], nga përmbajtja e akteve të administruara*

⁴³ Referohuni f. 37; 41; 43 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë **.5.2024.

⁴⁴ Referohuni f. 47 - 48 të vendimit të Komisionit.

⁴⁵ Arrestimi i shtetasis *** ***. është bërë në datën **.4.2021.

në dosje, konstaton se subjekti e ka njohur vetë z. *** **, të paktën që nga viti 2014, dhe jo nëpërmjet shtetasit *** **. Konstatohet se nga përmbajtja e deklaratës noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë **.1.2021, e paraqitur nga vetë subjekti në cilësinë e provës, literalisht shtetasi *** **, pronari i mjetit, ka pranuar njohjen në atë kohë me subjektin, duke mos përmendur faktin se e njej nëpërmjet shtetasit *** **, duke deklaruar se: “Unë kam njohje me shtetasin Petrit Vukaj dhe në vitin 2014 Petriti më thotë se do të shkonte në Greqi tek kunati i tij, për tre net, bashkë me familjen e tij, me mjetin e tij tip “Mercedes-Benz”... Unë i thashë merr mjetin tim ... kurse unë do mbaja mjetin e Petritit... Pasi erdhi nga Greqia, ai mori mjetin e tij, kurse unë mora përsëri automjetin tim”. Bazuar në rrethanën e faktit të njohjes reciproke, ata kanë shkëmbyer mjetet me njëri-tjetrin.

17.8.1 Së bashku me deklaratën e mësipërme, subjekti ka paraqitur kontratën noteriale të përdorimit të mjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2014, sipas të cilës shtetasi *** ** i ka dhënë në përdorim subjektit, automjetin për periudhën **.4.2014 – **.4.2015.

17.9 Komisioneri Publik vlerëson se deklarimi i subjektit se është njohur për procedimin penal të shtetasit *** ** vetëm nga rezultatet e hetimit, e më pas përpjekja e tij për ta paraqitur kontaktin si njohje jo e drejtpërdrejtë e tij, por e mikut të tij, *** **, dhe si kontakt rastësor, nuk është i besueshëm dhe nuk mbështetet në gjendjen faktike të akteve në dosje dhe, në thelb, është një përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit DH, pika 4 e aneksit të Kushtetutës.

17.10 Në përfundim, Komisioneri Publik çmon se problematikat e adresuara më lart në lidhje me kriterin e figurës, duhet të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 84/2016.

III. C Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

18. Komisioni, për vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në këto burime të vlerësimit: (i) Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, miratuar nga KLP; (ii) Ankesat e paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme; (iii) Denoncimet e publikut.

19. Komisioni, në aktin “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për disa çështje, të cilat do të gjejnë trajtim në vijim.

20. Kërkesa për gjykimin e çështjes penale me nr., të vitit 2015⁴⁶***

20.1. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:

20.2. Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes në hetimin e procedimit penal me nr.***, viti 2015, regjistruar për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit *** **. Me vendimin e datës **.11.2015, subjekti, z. Vukaj, në cilësinë e prokurorit të çështjes, i ka njoftuar akuzën të pandehurit *** ** dhe, më datë **.11.2015, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier me kërkesë për gjykimin e këtij procedimi penal. Me vendimin e datës **.12.2015, Drejtuesi i Prokurorisë vendosi zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit me një tjetër prokuror, ky i fundit në ndryshim nga vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit, në gjykimin zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier kërkoi pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit *** **, akuzuar

⁴⁶ Një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, me vendimin e datës **.6.2016, vendosi pushimin e çështjes penale, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

20.3. Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit...”,⁴⁷ lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me konstatimet si vijon: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar për të përcaktuar karakteristika e tij lidhur me fuqinë motorike;* (ii) *Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale të pandehurin për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale;* (iii) *Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin ***, ***, duke mos zbatuar parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.*

20.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] *nuk kam urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi autoteknik, pasi nga të dhënat që janë grumbulluar në dosjen hetimore, kanë dalë të qarta dy momente ...në germën “dh”, të pikës 2, të nenit 123, të Kodit Rrugor, përcaktohet se lejet e drejtimit të dhëna për kategoritë A, B...është e vlefshme përkatësisht për kategorinë A1 e A2 ..., nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se leja e drejtimit e kategorisë B është e vlefshme vetëm për kategorinë B1, si dhe motomjeti që drejtonte i pandehuri *** ***, kërkonte pajisje me leje drejtimi të kategorisë A1, e cila, siç evidentohet dhe më sipër, nuk përfshihet si e vlefshme për lejet e drejtimit të kategorisë B [...]*⁴⁸.

20.5. Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se: [...] *subjekti ka munguar në ndërmarrjen e veprimit hetimor, sikurse ishte moskryerja e aktit të ekspertimit për të konkluduar mbi vlefshmërinë e lejes së drejtimit që dispononte shtetasi *** ***, edhe për motomjet, akt i cili u krye nga Gjykata. Mbi këto fakte e rrethana, trupi gjykues çmon se subjekti shfaq mangësi sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 [...]*⁴⁹

20.6. Komisioneri Publik bashkohet me qëndrimin e Komisionit dhe shton sa vijon:

20.6.1. Ky procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal, i cili, në rastin e drejtimit të mjetit të motorizuar pa dëshminë përkatëse, kërkon referim në Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Një nga elementet e anës objektive të kryerjes së veprës penale të sipërcituar, është drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse. Në kohën e hetimit penal ndaj shtetasit *** ***, në fuqi ishte ligji nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”. Ky ligj në shtesat dhe ndryshimet që i ka bërë neneve të Kodit Rrugor, përkatësisht nenit 115, pika 3, parashikon se: “...në kategorinë A1 futen motomjetet deri në 125 cc dhe me fuqi ...”. Më tej, në nenin 123, pika 2, në shkronjat “dh” dhe “ë” parashikon se leja e drejtimit e dhënë për kategorinë B është e vlefshme për motomjetet e kategoritë A1, me kusht që mbajtësi i lejes së drejtimit të jetë të paktën 21 vjeç.

20.6.2. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi *** ***, është i pajisur me leje drejtimi automjeti të kategorisë B dhe, në kohën kur është ndaluar, ka qenë 32 vjeç (mbi 21 vjeç). Në vijim të ndjekjes logjike të hetimeve nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik për të përcaktuar karakteristika e motomjetit. Ndërkohë që akti i ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar është bërë gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata dhe ka rezultuar se motomjeti i të pandehurit është me fuqi motorike 110 cc. Sa më

⁴⁷ Referohuni f. 46 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

⁴⁸ Referohuni f. 58 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë **.5.2024.

⁴⁹ Referohuni pikës 42.5.9, f. 50-51 të vendimit të Komisionit.

sipër, si pasojë e moskryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, subjekti ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin *** ***, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, duke cenuar parimin e ligjshmërisë, të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.

20.7. *Komisioneri Publik*, për sa më lart, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar të meta në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, në kuptim të parashikimit të nenit 73, “*Aftësia profesionale e prokurorit*”, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim referuar si ligji nr. 96/2016), problematikë, e cila do të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21. *Ankesë e shtetases* *** ***,⁵⁰ e cila ka kërkuar informacion nëse është zbuluar autori i vrasjes së të birit, në vitin 2014, pasi çështja hetohet nga prokurori Petrit Vukaj. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.

21.1. Komisioni, bazuar në ankesën e shtetases *** ***, administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier⁵¹ dosjen e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, lidhur me vrasjen me armë zjarri të shtetasit *** *** (***) **, në qytetin e Patosit.

21.2. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:

21.2.1. Subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurori i çështjes në hetimin e procedimit penal me nr. ***, datë **.4.2014, regjistruar për veprën penale “*Vrasje me paramendim*”, “*Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit*”, parashikuar nga nenet 78/1, 278/4, të Kodit Penal. Në kuadër të hetimeve, për vrasjen me armë zjarri të shtetasit *** ***, në qytetin e Patosit, janë marrë në pyetje familjarët e viktimës dhe shtetasit e tjerë, që mund të kenë pasur dijeni për ngjarjen, janë kryer veprimet e përgjimit ndaj disa shtetasve të dyshuar, ekspertimet daktiloskopike ndaj disa shtetasve, ekspertimet biologjike, kimike, si dhe ekspertimi kimik dhe balistik i gëzhgojave të gjetura në vendin e ngjarjes, por nuk është bërë e mundur identifikimi i autorit të veprës penale. Në përfundim të hetimeve, subjekti, me vendimin datë **.7.2015, ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

21.3. Komisioni, në aktin “*Rezultatet e hetimit...*”,⁵² lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi duket se subjekti ka marrë vendimin e datës **.7.2015 për pezullimin e procedimit penal nr. ***/2015, jo sipas parashikimeve të nenit 326, të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se:

(i) Nuk ka administruar kopjen e përgjimeve të shtetasit *** ***, nga Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të këtij shtetasi, në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit *** *** (***) **, për të cilin janë ngritur dyshime se, së bashku me viktimën, kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali.

(ii) Nuk ka kryer veprime hetimore ndaj shtetasit *** ***, për të cilin ka pasur indicie se ka pasur marrëdhënie me viktimën, marrëdhëniet ndërmjet tyre janë prishur dhe mund ta ketë varrë.

⁵⁰ Ankesë e paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. *** prot., viti 2018.

⁵¹ Përcjellë me shkresën nr.***/* prot., datë **.12.2023.

⁵² Referohuni f. 54-55 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

(iii) Nuk ka marrë në pyetje, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të shtetasit *** ***, në kushtet kur familjarët e viktimës kanë ngritur dyshime se ka lidhje në vrasjen e viktimës.

(iv) Nuk ka kryer hetime ndaj shtetasve *** *** dhe *** *** në kushtet kur nga hetimet ka rezultuar se këta shtetas i kanë pasur para borxh viktimës.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore ndaj shtetasve: ** ***, *** *** (***) , *** ***, *** *** dhe *** *** të dyshuar si autor apo bashkautor në kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit *** *** (***) nga ana ime si prokuror, por në bashkëpunim dhe me oficerët e policisë gjyqësore, veprimet hetimore ndaj tyre nuk janë kryer, pasi nuk janë gjetur dyshimet se janë larguar jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të jashtëligjshme. Por dua të theksoj se, në fakt, ata janë hetuar, duke qenë subjekte të përgjimeve të ndryshme... Pikërisht për arsyet e mësipërme, edhe oficeri i policisë gjyqësore *** ***, në relacionin e tij, dt. **07.2015, ka sugjeruar pezullimin e hetimeve të procedimit penal të deleguar me nr. ***, të vitit 2014, duke ia deleguar dosjen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Fier së bashku me 40 CD-të (për transkriptim), të administruar në dosje. Relacion, të cilin e kam pranuar edhe unë si prokuror i çështjes, ku kam vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, datë **4.2014... Kam mendimin se, përderisa procedimi i mësipërm nuk ka përfunduar, Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje lidhur me vlerësimin tim, pasi këtë e ndalon paragrafi i parë i nenit 43 të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...].⁵³*

21.5. Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore... por nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale. Në këto kushte është vlerësuar në tërësi duke disponuar me pezullimin e çështjes për shkak të moszbulimit të autorit, ku vërehet gjithashtu se drejtuesi i organit të akuzës nuk ka rezultuar në një vendimmarrje ndryshe për të rinisur hetimet dhe, në këto kushte, vlerëson se nuk ka kompetencë shqyrtimi të thelluar në këtë çështje...Trupi gjykues, përveçse konstatoi se subjekti ka ndërmarrë një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e rrethanave të çështjes, por në statusin që ajo është, ku të dhënat ndaj hetimit janë të limituara apo të kufizuara, zbulimi i të cilave mund të dëmtojë hetimin, nuk krijon një panoramë të plotë për të vlerësuar rolin dhe pozitën e subjektit të rivlerësimit në të dhe, për pasojë, çmon se në këtë rast nuk mund të evidentohen shkaqe të tilla që të kualifikohen si mangësi të subjektit sipas neneve 40 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 [...].⁵⁴*

21.6. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***, viti 2014, nuk janë bindëse, pasi ka disponuar pezullimin e hetimeve pa ezauruar të gjitha veprimet e mundshme procedurale, sipas nenit 227⁵⁵ dhe nenit 326 të Kodit të Procedurës Penal, konkretisht si vijon:

i. Nga procesverbali datë **.2.2015, “Mbi transkriptimin e përgjimit të komunikimeve të numrit të telefonit celular, me numër ***, që i përket shtetasit *** ***, nga vendosja e CD-së në kompjuter, u konstatua se ajo nuk hapej dhe nuk mund të lexoheshin të dhënat që mund

⁵³ Referohuni f. 55 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë **.5.2024.

⁵⁴ Referohuni f. 57 të vendimit të Komisionit.

⁵⁵ Neni 277: “1. Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. 2. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore”.

të ketë brenda. Nga ana e subjektit, nga aktet e administruara në dosjen e procedimit penal, nuk rezultojnë të jetë kërkuar kopje tjetër CD e aksesueshme pranë Sektorit të Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme. Po kështu, subjekti nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore lidhur me këtë shtetas, në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit * *** (***) , për të cilin janë ngritur dyshime se, së bashku me viktimën, kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali.

ii. Nga transkriptimi i përgjimeve telefonike të njërit prej familjarëve të shtetasit të vrarë në Itali, ka rezultuar se gjatë bisedimeve të përqendruara rreth personit me emrin *** *** “***”, ai ka deklaruar se ata mund të jenë zemëruar me njëri-tjetrin (me viktimën *** ***), dhe prandaj e kanë vrarë. Nga shqyrtimi i dosjes penale nuk rezultojnë të jenë kryer veprime hetimore ndaj shtetasit *** ***, për të cilin ka pasur *indicie* për vrasjen e viktimës.

iii. Nga procesverbali datë **.2.2015, për marrjen e të dhënave nga shtetasi *** *** (daja i viktimës), si person që ka dijeni për veprën penale, rezultojnë se me shtetasin *** *** viktimë ka pasur mosmarrëveshje dhe familjarët e tij janë akuzuar nga vjehri i viktimës. Nga hetimet e kryera nga subjekti rezultojnë që ky shtetas nuk është marrë në pyetje, si dhe nuk janë kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të tij. Në të njëjtat marrëdhënie, viktimë ka rezultuar me *shtetasit* *** *** dhe vëllanë e tij, *** ***, por nga hetimet e kryera nga subjekti, nuk rezultojnë që të jenë kryer veprime procedurale me këta shtetas.

21.7. Në përfundim, *Komisioneri Publik*, lidhur me këtë procedim penal, vlerëson se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e pezullimit të procedimit penal, tregon për mangësi sipas përcaktimit të nenit 73/2/3, “*Aftësia profesionale e prokurorit*”.

21.8. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje, *Komisioneri Publik* vlerëson se Komisioni nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të parashikuara nga neni E, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, por legjitimohet të analizojë e vlerësojë këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁵⁶: [...] *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve që janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit, që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit* [...] dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë.

22. Ankesë e shtetasit *** ***⁵⁷, i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit, padrejtësisht, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e tij për prishjen e banesës.

22.1. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezultojnë sa vijon:

22.1.1. Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes në hetimin e kallëzimit penal me nr. ***, të vitit 2015, mbi bazën e materialeve procedurale të dërguara më datë **.6.2015, nga Komisariati i Policisë Fier. Me vendimin e datës **.6.2015, subjekti, z. Vukaj, ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal me nr. ***, të viti 2015, për veprat penale të parashikuara nga neni 150, “Shkatërrimi i pronës”, dhe neni 277, “Vetëgjyqësia” të Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprën penale.

22.1.2. Referuar fashikullit të hetimit penal rezultojnë se janë kryer disa veprime hetimore dhe mbajtur akte procedurale të tilla si procesverbale të marrjes së të dhënave nga persona që kanë dijeni për veprën penale, procesverbale për këqyrje e marrje të dokumenteve, sipas të cilave rezultojnë se ankuesi *** *** pretendon se është shkatërruar banesa e tij me vendndodhje në

⁵⁶ Shihni vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr. 16/2020 (JR); nr. 28/2020; (JR) nr. 25/2023.

⁵⁷ Ankesë e regjistruar manualisht në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. ***, viti 2015.

fshatin *** ***, rrethi Fier, nga nipit i tij, *** ***, i cili me vetëgjyqësi e ka shkatërruar, duke pretenduar se është në pronësi të tij.

22.1.3. Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, arsyeton se pretendimet mbi pronësinë për banesën e vjetër nuk provohen me dokumentet e paraqitura. Pavarësisht se u paraqitën aktet të marrjes së tokës në pronësi, të cilat në vetvete pasqyrojnë sipërfaqe toke bujqësore dhe trualli, të trajtuar në favor të familjes bujqësore, në asnjë prej tyre nuk evidentohet banesa objekt kallëzimi.

22.2. Komisioni, me aktin “Rezultatet e hetimit...”,⁵⁸ lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me konstatimet si vijon [...] (i) Subjekti duket se ka marrë vendimin e datës *.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal pa u plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, si më poshtë vijon: këqyrjen në vend të banesës, kryerjen e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa e pretenduar nga kallëzuesi është në pronësi të tij dhe nëse kjo banesë ishte shkatërruar si pasojë e amortizimit apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj; (ii) Duket se konkluzioni i subjektit në vendimin e datës *.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal, nuk mbështetet në faktet dhe provat e administruara, nga ku rezulton se kallëzuesi ka paraqitur AMTP-në dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit *** *** dhe se nuk është provuar në dokumentet e paraqitura pronësia mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi; (iii) Duket se përfundimi i subjektit në vendimin e datës *.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit se “banesa e kallëzuesit ka qenë e vjetër dhe e amortizuar dhe, për rrjedhojë, nuk kemi shkatërrim të pronës me dashje”, nuk është i bazuar në ndonjë akt të përgatitur nga ekspertë të fushës, me njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit; (iv) Duket se në vendimin e datës *.6.2015, për mosfillimin e procedimit penal, subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, në kushtet kur: ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil, lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal; kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë së banesës (sipas arsyetimit të mësipërm); sipas aktit të ekspertimit të procesit civil të paraqitur nga kallëzuesi, banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve (e shkatërruar) dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari [...].

22.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] edhe pas regjistrimit të kallëzimit penal pranë Prokurorisë, përveç veprimeve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, është urdhëruar kryerja e veprimeve verifikuese nga ana ime dhe konkretisht janë marrë dhe këqyruar dokumente sipas procesverbalit të datës *.6.2015, është pyetur shtetasi *** ***... dhe shtetasi *** ***... Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme verifikuese, unë kam arritur në konkluzionin se duhej të vendosej mosfillimi i procedimit penal... Të gjitha pretendimet e evidentuara në raportin e KPK-së se unë duhet të kryeja veprime të ndryshme hetimore, në fakt i përkasin procesit civil dhe jo atij penal. Në rastin konkret, kontradiktat që kanë patur palët midis tyre po ndiqej civilisht dhe kallëzimi që ka bërë shtetasi *** *** është bërë me qëllimin e vetëm për të rënduar palët e tjera që ai ishte në konflikt pronësie. Fakti që vendimi i mosfillimit nuk është ankimuar edhe nga pala kallëzuese, mbështet në rastin konkret vendimin tim të mësipërm [...] ⁵⁹.

⁵⁸ Referohuni f. 62 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

⁵⁹ Referohuni f. 57 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë *.5.2024.

22.4. Komisioni, bazuar në sa më lart, ka arritur në përfundimin: [...] *Trupi gjykues vlerëson se çmuarja e rrethanave dhe fakteve të konkluduara nga subjekti në këtë vendimmarrje gjendet e bazuar në logjikën dhe interpretimin e tij, në raport me kërkesat e nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, ku rezulton gjithashtu se kallëzuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen mangësi të tilla, të cilat mund të përbëjnë shkak cenimit të kriterit profesional të subjektit [...]*⁶⁰.

22.5. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, vlerëson sa vijon: (i) Sikurse praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë⁶¹ ka arsyetuar: [...] *rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi; [...]* (ii) Në dispozitivin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, subjekti ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”. Nga analizimi i dispozitave ligjore për secilën veprë penale në raport me faktet, rezulton si vijon: (ii.a) *Lidhur me veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, rezulton se nuk është bërë këqyrja në vend për të evidentuar shkatërrimin e banesës së pretenduar nga kallëzuesi, por janë administruar vetëm dokumentet e paraqitura nga kallëzuesi, konkretisht: AMT-në, listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit *** ***, si dhe aktin e ekspertimit të dorëzuar në procesin gjyqësor civil. Në këto kushte, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, ishte e nevojshme këqyrja në vend e banesës së kallëzuesit, si dhe eventualisht kryerja e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa ishte shkatërruar me kalimin e kohës apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj. Më tej, subjekti vendimin për mosfillimin e procedimit penal, ndërmjet të tjerave, e mbështet në arsyetimin se kallëzuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e pronësisë mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi. Për sa i përket këtij arsyetimi, objekt i veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar paprekshmërinë e pronësisë mbi sendet, përfshirë disponimin, gëzimin dhe përdorimin, si marrëdhënie të ndërvarura. Në rastin konkret rezulton se kallëzuesi për vërtetimin e pronësisë ka paraqitur AMTP, ku pasqyrohet sipërfaqja e truallit, si dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit ** ***, ku banesa e kallëzuesit figuron në listën emërore të fshatit *** ***; (ii/b) *Lidhur me veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, Gjykata e Lartë⁶² ka arritur në përfundime unifikuese lidhur me cilësimin juridik të veprës penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, sipas së cilës: [...] vetëgjyqësia parashikon ushtrimin e një të drejte nga personi që i përket ose kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent. Kjo dispozitë synon jo vetëm të mbrojë ushtrimin e autoritetit shtetëror, por edhe që të parandalojë e ndëshkojë sjelljet dhe veprimet shoqërisht të rrezikshme me të cilat autori i atribuon vetvetes të drejtën për të realizuar një të drejtë a zgjidhur një mosmarrëveshje që ka më të dëmtuarin, duke shmangur rrugën e parashikuar nga ligji për t’iu drejtuar organit kompetent shtetëror [...]. Në rastin konkret rezulton se: (i) Ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal. (ii) Kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që vërteton të drejtën pronësore (sipas arsyetimit të mësipërm). (iii) Sipas aktit të ekspertimit të procesit civil të paraqitur nga**

⁶⁰ Referohuni pikës 44.4, f. 59, të vendimit të Komisionit.

⁶¹ Referohuni vendimit nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁶² Referohuni vendimit nr.1, datë 25.3.2005, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

kallëzuesi, banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve (e shkatërruar) dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari. Sa më lart, rezulton se subjekti, në vendimin e datës **.6.2015, ka arritur në përfundimin për mosfillimin e kallëzimit penal për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, pa analizuar elementet e figurës së veprës penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes. (iv) Për sa i përket shpjegimit se ka vendosur mosfillimin për shkak se mosmarrëveshja ishte duke u shqyrtuar nga Gjykata Civile, ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nenit 70 dhe 71 të tij, ku përcaktohen normat lidhur me efektet e ndërsjella të vendimit penal dhe procedimeve civile dhe administrative me rrjedhoja në hetimin penal.

22.6. Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

23. Komisionit, nga informacioni i administruar nga KLP-ja⁶³, Gjykata e Posaçme e Apelit⁶⁴ dhe Gjykata e Lartë⁶⁵, i ka rezultuar se në ngarkim të subjektit është regjistruar *procedimi penal nr. ***, i vitit 2015*, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal.

24. Komisioni, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.10.2023, ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier dosjen e *Procedimit penal nr. ***, viti 2015*,⁶⁶ regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi 3 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit *** ***, për të cilin subjekti është marrë në përgjegjësi penale nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda⁶⁷.

24.1 Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:

24.1.1 Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes për procedimin penal me nr. ***, të vitit 2015, e regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi 3 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit *** ***. Referuar aktit toksikologjik-ligjor me nr.***, datë **.4.2015, për shtetasin *** *** rezulton se mostra e gjakut të shtetasit *** *** është e koaguluar dhe, si e tillë, nuk përbën një mostër të pranueshme për t’u analizuar. Në këto kushte, analiza nuk mund të kryhet. Me aktin procedural “Diskutim përfundimtar për gjykimin e çështjes penale nr.***, të vitit 2015, në ngarkim të pandehurit

⁶³ Dosja e analizimit të aftësive profesionale - shkresë nr. ***/* prot., datë **.1.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

⁶⁴ Shkresë nr. ***/* prot., datë **.10.2023.

⁶⁵ Shkresë nr. ***/* prot., datë **.10.2023.

⁶⁶ Në funksion të procedimit penal nr. ***, viti 2015, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, sipas informacionit të përcjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Posaçme e Apelit dhe Gjykata e Lartë është administruar edhe ky procedim penal.

⁶⁷ Me vendimin nr.***, datë **.10.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit është deklaruar fajtor dhe është dënua me 3 vjet burgim. Bazuar në nenin 59 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për subjektin dhe është vënë në provë për një periudhë 18 muaj, me kusht që gjatë kohës së provës subjekti të mos kryejë vepër tjetër penale. Me vendimin nr.***, datë **.11.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ka prishur vendimin nr.***, datë **.10.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ka pushuar çështjen për subjektin e rivlerësimit.

*** **”, subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të pandehurit *** ** për veprën penale parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal dhe dënimin me tre vjet burgim, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit *** ** t’i zbritet 1/3 e dënimit dhe, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit, për një afat prej 3 vjetësh, dhënien e dënimit plotësues “ndalim për të drejtuar automjete”, për një periudhë prej 2 vjetësh.

24.1.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, me vendimin nr. **-2015-***, datë **.10.2015, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit *** ** për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal dhe dënimin me 2 vjet e 6 muaj burgim, zbatimin e nenit 406/1, duke i zbritur 1/3 e dënimit dhe dhënien e dënimit plotësues. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin përkatës nr. **-2016-***, datë **.2.2016.

24.2 Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit...”,⁶⁸ i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për konstatimet si vijon: (i) *Subjekti në dokumentin “Diskutim përfundimtar”, drejtuar Gjykatës, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të pandehurit, duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, pa marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale si: (1) shkallën e pakujdesisë së autorit të saj, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; (2) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit ***. ***.* (ii) *Subjekti, nëpërmjet kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duket të ketë favorizuar të pandehurin dhe kjo kërkesë e subjektit së bashku me rrethanat e konstatuara në çështjen penale në ngarkim të tij mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut tek organet e drejtësisë.*

24.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] në Raportin e KPK-së është evidentuar fakti se rrethanat e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe pikërisht këtë gjë e kam patur parasysh, kur kam paraqitur diskutimin përfundimtar para Gjykatës. Po në diskutimin përfundimtar kam patur parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, por në dallim nga sa pretendohet në raport, këto rrethana unë i kam vlerësuar në kuadrin e formës së fajit, që ka qenë nga pakujdesia. Fakti që ligjvënësi pezullimin e ekzekutimit të dënimit e lidhë me masën e dënimit deri në 5 vjet, do të thotë që shkalla e rrezikshmërisë shoqërore e veprës, jo në çdo rast duhet të jetë e vogël [...] ⁶⁹.

24.4 Komisioni ka arritur në përfundimin se:[...] Në këtë çështje duhet konsideruar fakti që në këtë rast organi i akuzës/subjekti dispononte atributin e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, për sa kohë vepra penale për të cilën akuzohej i pandehuri lejonte një masë dënimi deri 5 vjet, në raport me rrethanat lehtësuese, të cilat gjenden të arsyetuara nga subjekti në kërkesën e tij, më konkretisht: “...të mos qenit i dënuar me parë, qëndrimi pohues ndaj akuzës, pendimi i thellë..., normalizimi i marrëdhënieve me familjarët e viktimës, fakti që është i martuar dhe me fëmijë të mitur”. Po ashtu, duket se subjekti ka vlerësuar rrethanat e kësaj çështjeje në raport me kriteret e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar në dokumentim ‘Diskutime përfundimtare’, nën kuadrin e formës së fajit nga pakujdesia, ku, megjithëse i pandehuri nuk e ka dëshiruar pasojën, ajo ka ardhur. Subjekti në kërkesën e tij para Gjykatës i është referuar dispozitës që parashikon dënimin maksimal deri në 5 vjet dhe, për rrjedhojë, lejon aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe, në zbatim të kësaj të fundit, ka konsideruar faktet

⁶⁸ Referohuni f. 52-53 të aktit “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”.

⁶⁹ Referohuni f. 53-54 të aktit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ”, datë **.5.2024.

e provuara se i pandehuri ka qenë i padënuar më parë dhe se ka rregulluar marrëdhëniet me familjarët e viktimës. Trupi gjykues në këtë arsyetim mban në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për çështje të kësaj natyre. Trupi gjykues, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, çmon se jemi përpara rastit kur logjika e subjektit nuk mund të zëvendësohet, për sa kohë në dosje provohet se subjekti ka kryer veprime hetimore të plota, të vlerësuara edhe nga organi gjyqësor, porse ky i fundit nga vlerësimi i rrethanave në përmbushje të kriterëve ligjore që kërkon neni 59 i Kodit Penal, në ndryshim nga subjekti, ka disponuar me një masë me të lehtë se ajo e kërkuar prej tij [...] ⁷⁰.

24.5 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni për arsyet në vijim: (i) Neni 59 i Kodit Penal i jep të drejtën Gjykatës që, në raste të veçanta, kur jep dënimin me burgim gjer në 5 vjet, të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë, duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, por, në çdo rast, Gjykata duhet të ketë parasysh rrezikshmërinë e paktë të personit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sikurse konstatohet në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, lloji i veprës penale ka rëndësi, por kushtet kryesore për aplikimin e kësaj dispozite lidhen kryesisht me të pandehurit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale; (ii) Për sa i përket pretendimit të subjektit se në diskutimin përfundimtar ka pasur parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe këto rrethana i ka vlerësuar në kuadrin e formës së fajit që ka qenë nga pakujdesia, nga shqyrtimi i dokumentit “Diskutim përfundimtar”, ndërmjet të tjerave, konstatohet se subjekti, pasi ka parashtruar në mënyrë kronologjike veprimet hetimore, arrin në konkluzionin se i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, vijon me arsyetimin se pavarësisht se i ka shkaktuar vdekjen viktimës, nuk e ka dëshiruar pasojën, e më pas në lidhje me masën e dënimit ka kërkuar nga Gjykata: “Të marrë parasysh rrezikshmërinë mesatare të veprës penale”, rrethanë, e cila nuk është vlerësuar si e tillë nga Gjykata e Rrethit, e cila ka vlerësuar se vepra penale është mbi mesatare, duke pasur parasysh mënyrën dhe mjetin që ka përdorur i pandehuri për kryerjen e tyre, si dhe pasojën konkrete që ka ardhur, vlerësim i cili është gjendur i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit.

24.6 Sa më lart, vërtetohet se subjekti ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, duke mos vlerësuar: (i) shkallën e pakujdesisë së autorit të veprës penale, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; dhe (ii) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit ***. ***.

24.7 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

25. Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha konkluzionet e mësipërme, në një vlerësim tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Vukaj, gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

26. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit,

⁷⁰ Referohuni pikës 42.9.13, f. 55-56 të vendimit të Komisionit.

referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

27. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

28. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

29. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

30. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 774, datë 14.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Vukaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA